



Datë: 07.08.2025

Numër Protokolli: 5369/2025

A.nr.1093/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1093/2025 të datës 09.06.2025 të parashtruar nga ankuesja M.D-K, kundër organit të punësimit Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1093/2025, e datës 09.06.2025, e parashtruar nga ankuesja M.D-K.

II. Anulohet Konkursi me numër reference RN00017239 për pozitën e punës *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv*, i shpallur me datë 20.03.2025 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Menaxherja e Personelit në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, M.D-K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 5.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër Reference RN00017293 për Grupin e Administrimit të

Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv, i shpallur me datë 20.03.2025 nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, 18.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 23.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 4997/2025 të datës 23.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3398/2025, të parashtruar nga ankuesja më datë 22.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00017239; Njoftimin e datës 29.04.2025; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 30.05.2025; Dokument identifikimi; Vërtetimin e datës 13.11.2018; Letër referencën e datës 18.02.2015; Vërtetimin e datës 08.02.2016; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 23.06.2025; Aprovimin për shpalljen e konkursit të datës 20.03.2025; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit me numër protokolli 2781 të datës 06.05.2025, si dhe akt emërimet dhe vendimet e tyre; Aplikacionin e kandidates G.M të datës 19.04.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës; Formularët e vlerësimit të esesë dhe intervistës me gojë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e bazuar, ***sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, më datë 20.03.2025, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00017239, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën e punës *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv*, me afat aplikimi nga data 21.03.2025 deri më datë 19.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsejtë 88 kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listë të ngushtë 42 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja e cila i është nënshtruar testit me shkrim, nga e cila fazë vlerësimi ka arritur gjithsejtë 42.2 pikë, të pamjaftueshme për të vazhduar në fazën tjetër të vlerësimit atë të intervistës me gojë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, me datë 30.05.2025 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 3182, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja

G.M me gjithsejtë 94 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimit, është shpallur kandidate fituese për pozitën e punës Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kandidatja fituese nuk i plotëson kriteret e pozitës së shpallur dhe se e njëjta është favorizuar nga Komisioni i Pranimit, andaj kërkon rishkrimin e procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes, rishikimin e vendimit për përzgjedhjen e kandidatit si dhe shqyrtimin e masave disiplinore ndaj përgjegjësve.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00017239, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë, **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).Arsim i lartë i paspecifikuar. **Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës I të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës VI të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 11.02.2025.

Duke marrë për bazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimit Nr.08/226 të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv* nuk parashihet në këtë katalog, mirëpo pozita *Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve*, identifikohet me kodin SHC-1013 si dhe pozita *Zyrtar për Arkiv* e cila identifikohet me kodin SHC-1043, dhe që të dyja këto pozita hynë në kuadër të Grupit të arkivit- dokumentacionit, ku fusha e kërkuar e arsimit është ***Juridik/Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë, Antropologji, Ballkanistikë.***

Në këtë kuptim, duke u bazuar në dispozitat e aplikuara të nenit 19, nenit 20 si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: ***“19. Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 20.1. Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 20.2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për pozitën përkatëse. 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit***

të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. **Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.**”, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë shpalljen e konkursit me numër reference RN00017239 të datës 20.03.2025 për pozitën e punës Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv e ka shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimit Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojca Nr.2.Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, gjegjësisht Gr.Nr.7 të Arkivit dhe Dokumentacionit, pasi që pozita e shpallur bazuar në përshkrimin e përgjithshëm të punës dhe vetë emërtimin e saj rezulton se hynë në kuadër të këtij grupi të posaçëm, ndërsa sipas konkursit e njëjta pozitë është përcaktuar në Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, dhe për rrjedhojë pozitës në fjalë i janë ndryshuar kriteret e arsimit të cilat janë të përcaktuara sipas rregullores së lartcekur dhe Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, në atë mënyrë që nuk është përcaktuar fusha specifike e studimeve të lartë të nivelit të parë (Bachelor), ndërsa është fakt i pa kontestueshëm se për Grupin e arkivit- dokumentacionit, arsimimi i kërkuar është: **Juridik/Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë, Antropologji, Ballkanistikë**, dhe se në rrethanat e rastit konkret të gjithë kandidatëve të cilët nuk posedojnë diplomë të arsimit të lartë në këto fusha të studimeve bachelor në mënyrë të kundërligjshme ju është lejuar e drejta e pjesëmarrjes në këtë procedurë të rekrutimit.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të rekrutimit shkeljet janë evidentuar që nga shpallja e konkursit me numër reference RN00017239 të datës 20.03.2025, ashtu që nuk janë përfillur kriteret e aprovuara lidhur me klasifikimin e pozitës, duke ndryshuar më pastaj edhe kriteret për fushën e arsimit për pozitën Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkiv, ndaj Kolegji i Këshillit, nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesën e datës 09.06.2025, pasi që për shkak të pa ligjshmërive të lartë theksuara, konstatimi nëse pretendimet e ankueses janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar vetëm për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1093/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.D-K;
- Menaxheres së Personelit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.